

Festivali polip:

KUJTDO QË I BËHET VONË! ÇKA PËR ÇËSHTJEN E AMBIENTIT?

14-16 maj, Prishtinë

Shfaqje teatri: **ZOE**

 Lokacioni: Teatri Kombëtar i Kosovës, Prishtinë

 Data: E shtunë, 16 maj

 Ora: 20:00

 Rezervoni biletën tuaj në: info@qendra.org] ose ne +383 44 430 693

Gjuha: anglisht. *Për shkak të natyrës së shfaqjes, për publikun përkthimi në shqip i teksti do të ofrohet në formë fizike*

Përshkrimi i shfaqjes:

Çfarë do të thotë të jesh i gjallë në një botë ku njerëzit, makinat dhe natyra komunikojnë? Kur kufijtë midis specieve shpërbëhen? Çfarë ndodh kur planeti bëhet rrëfyës – kur gurët flasin, peizazhet marrin frymë dhe trupat dhe algoritmet ndërthuren në një vallëzim të çuditshëm? Çfarë jemi në gjendje të bëhemi?

Në një ndërthurje unike të poezisë së fantashkencës, muzikës elektronike dhe skenografisë gjithëpërfshirëse, performanca muzikore *ZOE* krijon një peizazh ku format e jetës njerëzore dhe jo-njerëzore, teknologjia dhe natyra janë të ndërthurura në mënyrë të pandashme. Një rrëfim jo-linear dhe shumëshqisor, i thurur nga trupi, zëri, tingulli dhe hapësira, na fton të rishqyrtojmë çfarë mund të nënkuptojë "jeta" në një të ardhme spekulative përtej Antropocenit. *ZOE* është një rrëfim polifonik mbi procesin e pandërprerë të formimit të Tokës – të bimëve, kafshëve, makinave dhe gjithashtu të njerëzve.

Në *ZOE*, nuk je një vëzhgues i largët; ti bëhesh pjesë e skenografisë. Ti takon *ZOE*-n, një ekosistem të ndjeshëm dhe një peizazh të përkohshëm që ekziston mes realitetit dhe fantashkencës. Në këtë terren në ndryshim, mund të hasësh gurë që ndihen si trupa – dhe kur e vendos veshin mbi ta, ata të flasin. Krijesa jo-njerëzore ndërveprojnë me ty në një intimitet të paprecedent. Shfaqjen hibride të njeriut, makinës dhe kafshës, duke rrotulluar karuselin – duke u spiralluar ngadalë nga e ardhmja drejt këtu dhe tani.

Koncepti, drejtimi artistik, skenografia dhe teksti: Lisa Horvath / Regjia skenike dhe produksioni: Lisa Horvath dhe Victoria Fux / Muzika dhe dizajni i zërit: Sara Trawöger / Koreografia dhe

performanca: Maja Karolina Franke / Vokalet, performanca dhe kostumet: Kristin Gerwien / Zëri (gjermanisht): Christina Lederhaas / Zëri (anglisht): Tara Khozein / Tingulli dhe ndriçimi: Tom Grassegger / Dramaturgjia: David Wimmer-Wallbrecher / Mbështetje artistike: Sophia Scherer / Drejtimi gjuhësor: Martin Brachvogel / Konsulencë koreografike: Marta Navaridas / Përkthimi në anglisht: Kate McNaughton

polip
FESTIVAL

ZOE

E shtunë, 16 maj
20:00 – 21:20

Vendi i ngjarjes:
**Teatri
Kombëtar
i Kosovës**

Prodhuar nga:
UniT Graz
Në anglisht

Rezervo vendin tënd në:
info@qendra.org

FUTURE NARRATIVES
for Planet Earth

qendra
multimedia

 Austrian
Embassy
Pristina

